



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 24.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston situata e konfliktit të interesit në rastin me Nr. Protokoli: HQPCRB-0046/25, për zyrtarin e lartë z. Izahir Kuka u.d. Menaxherit të Prokurimit, pasi që i njëjti në cilësinë e menaxherit të prokurimit ka nënshkruar kontratën publike me titull: “Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë” me Operatorin Ekonomik “NIKA PRO-ING” SH.P.K. me seli në Ferizaj, me të cilën kompani i njëjti ka marrëdhënie afariste. Me veprimet e tilla zyrtari Izahir Kuka, ka rënë ndesh me neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, lidhur nenin 17, nenin 6, dhe nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, nenit 24, paragrafi 6, lidhur me nenin 19, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, dhe paragrafi 4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kërkon nga Komuna e Kaçanikut:
 - a) Anulimin e aktit/kontratës me titull: “Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë” me numër të Prokurimit: KA652-6759-5-2-1, të nënshkruar me datë: 20.08.2024, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe
 - b) Inicimin e procedurës disiplinore ndaj z. Izahir Kuka, për shkeljet e dispozitave të nenit 24 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për veprë penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtit bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

Arsy e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Izahir Kuka, zyrtar i lartë i prokurimit në Komunën e Kaçanikut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/1-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

"[...] Në cilësinë e u.d. të Menaxherit të Prokurimit në Komunën e Kaçanikut, z. Izahir Kuka, me datën 20.08.2024, nënshkroi kontratën publike për "Rregullimin e hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë-Faza I", me nr. të prokurimit 652-24-6759-5-2-1, me kompaninë "NIKA PRO-ING" Sh.P.K., në vlerë të përgjithshme të kontratës 73,643.96 euro.

Ndërkohë, në aktivitetin e prokurimit publik "Rivlerësimi i Asteve në Ndërmarrjen Publike NH "Iber Lepenc" SH.A., me nr. të prokurimit IL-24-8711-2-2-1, z. Izahir Kuka, paraqitet si pjesë e kompanisë "NIKA PRO-ING" SH.P.K.. Në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar, është po ashtu një referencë e kësaj kompanie për Izahir Kuka, e lëshuar me datën 29.12.2023, ku thuhet se z. Izahir Kuka, ka punuar në kompani me marrëveshje për projekte të "NIKA-PRO-ING" SH.P.K., për projekte të ndryshme si ndërtim, renovim etj, dhe se ende vazhdon punën profesionale në kompani.[...]"

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me shkresën zyrtare DPKI-01/480/25, e ka njoftuar zyrtari e lartë publik z. Izahir Kuka, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë dhe ballafaqimit të fakteve lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, është mbajtur një takim me z.Izahir Kuka, zyrtar i lartë i prokurimit në Komunën e Kaçanikut, me ç' rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit. Në takim, zyrtari i lartë publik ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me faktet e prezantuara duke theksuar se: *"Si zyrtar i lartë i prokurimit jam që nga viti 2012.Me vendim të Kryetarit të Komunës me datë 01.07.2024, jam caktuar si ushtrues detyre i menaxherit të prokurimi. Kurse me kompaninë "NIKA PRO-ING" Sh.P.K. , kam marrëveshje si konsulent në kompani".*

Nga informatat që përmban raportimi për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur në Agjenci, faktet nga dokumentacioni i siguruar sipas detyrës zyrtare, rezultojnë gjendja faktike si në vijim:

Me datë 01.07.2024, me vendimin 01/Nr.104/02-15066/24, Kryetari i Komunës së Kaçanikut ka caktuar z. Izahir Kuka ushtrues të detyrës së Shefit/Udhëheqësit të prokurimit në Zyrën e prokurimit;

Më datën 20.08.2024, është nënshkruara kontrata publike me titull "Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë", nga Izahri Kuka U.D. i Menaxherit të Prokurimit në Komunën e Kaçanikut dhe përfaqësuesi i autorizuar i OE "NIKA PRO-ING" Sh.P.K. Ferizaj.

Sipas dosjes është identifikuar se me datë 29.12.2023, Drejtori i Kompanisë "NIKA PRO-ING" Sh.P.K. Ferizaj, ka lëshuar referencë për zyrtarin e lartë Izahir Kuka, ku thuhet: I njëjti ka punuar në kompaninë me marrëveshje për projektet të ndryshme si ndërtim, renovim etj, dhe se i njëjti vazhdon ende me punë profesionale në këtë kompani;

Po ashtu si fakt tjetër të lidhjes së z. Izahri Kuka me kompaninë është identifikuar, kontrata e punës për kohë të caktuar për projektin: "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc" Sh.A. e lidhur me kompaninë "NIKA PRO-ING" Sh.P.K. Ferizaj, me datë 30.10.2024.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se, ekziston rrethana e gjendjes së konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë Izahir Kuka, pasi që i njëjti në cilësinë e u.d. Menaxherit të Prokurimit, me datë 20.08.2024, ka nënshkruar kontratën publike me titull: "Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë" me Operatorin Ekonomik "NIKA PRO-ING" Sh.P.K me seli në Ferizaj, me kompaninë që ka (pasur) marrëdhënie afariste në pesë (5) vitet e fundit, duke rënë ndesh kështu me neni 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, lidhur me nenin 17, nenin 6, dhe nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me dispozitën e nenit 9, paragrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përcaktuar se:

"Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:

1.8 të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit".

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit), paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Gjithashtu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."

si dhe nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar.

Në rastin konkret, zyrtari i lartë Izahir Kuka ka marr pjesë në vendimmarrje, duke nënshkruar kontratën me titull: "Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë", me OE "NIKA PRO-ING" Sh.P.K." Ferizaj, me datë 20.08.2024, me të cilin ka marrëdhënie afariste, duke plotësuar kështu edhe kushtin tjetër kumulativ, që është **ekzistimi i interesit privat i personit të afërt me të**, përkatësisht, **përfitimi i çfarëdo përparësie për organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste**, kështu është gjendur në situatë të konfliktit të interesit, duke rënë ndesh me neni 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, lidhur me nenin 17, nenin 6, dhe nenin 3, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.6 dhe 1.12, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi dhe konstatoj se ekziston konflikti i interesit për zyrtarin e lartë z. Izahir Kuka, pasi që i njëjti me Operatorin Ekonomik "NIKA PRO-ING" SH.P.K. me seli në Ferizaj, në cilësinë e u.d. Menaxherit të Prokurimit, ka nënshkruar kontratën publike me titull: "Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë", me të cilën kompani i njëjti ka marrëdhënie afariste, duke rënë ndesh kështu me dispozitat e sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II.A) Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon anulimin Kontratës me titull: "Rregullimi i hapësirave rekreative Shtegu i Lirisë, Faza e I-rë" me numër të Prokurimit: KA652-6759-5-2-1, datë: 20.08.2024, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe atë konform nenit 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili ka përcaktuar se;

“Agjencia inicion veprimet ligjore në institucionet kompetente, me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj për aktet dhe kontratat administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e saj”.

dhe nenin 24 paragrafi 6, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia inicion procedurën administrative dhe/ose gjyqësore për anulimin e akteve dhe për obligimin e zyrtarit përgjegjës për shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit.”*

II. B). Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon iniciimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtarit të lartë Izahir Kuka, për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe atë sipas nenin 24, paragrafi 1, të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se:

“Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësisë eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji duhet ta njoftojnë Agjencinë për iniciimin dhe rezultatin e atyre procedurave.”

Dhe paragrafi 2 i nenit 24 të këtij ligji i cili ka përcaktuar se: *“Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit sipas legjislacionit në fuqi”.*

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, në pajtim me nenin 24, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

“Agjencia, çdo zyrtar, udhëheqës i zyrtarit dhe çdo institucion ushtrojnë kallëzim penal në prokurorinë e shtetit kompetente ndaj zyrtarit i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës”,

...lidhur me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku përcaktohet se:

Agjencia është përgjegjëse për: “Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent”.

VI. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në kuptim të paragrafit 4 të nenit 19, si dhe paragrafit 1 të nenit 24 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Komuna e Kaçanikut duhet ta njoftoj Agjencinë lidhur me veprimet e ndërmarra në kuptim të pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut
- Zyrtarit të lartë Izahir Kuka
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

